

V E N D I M
Nr.3, datë 9.1.1995

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.530, DATË
17.10.1994 “PËR MËNYRËN E NDARJES SË APARTAMENTEVE TË NDËRTUAR NGA
ENTI KOMBËTAR I BANESAVE”**

Me propozimin e Ministrisë së Mbrojtjes, Ministrisë së Brendshme dhe Shërbimit Informativ Kombëtar, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 530, datë 17.10.1994, bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 4 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje: “Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Brendshme dhe SHIK-u, kur sigurojnë fonde për banesa dhe sheshe ndërtimi, ia vënë ato në dispozicion Entit Kombëtar të Banesave, së bashku me listat e punonjësve të tyre që do të strehohen në këto banesa”.

2. Në pikën 7 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje: “Banesat në proces të Ministrisë së Mbrojtjes, Ministrisë së Brendshme dhe SHIK-ut, të përfunduara me fondet e Entit Kombëtar të Banesave, do të ndahen për punonjësit e tyre të pastrehë, të transferuar ose për përmirësimin e kushteve të banimit, kundrejt listave dhe autorizimeve që këto dikastere do t’i dërgojnë Entit Kombëtar të Banesave, duke respektuar aktmarrëveshjet që qytetarët e tjerë kanë lidhur me pushtetet lokale për efekt të planeve rregulluese”.

3. Në pikën 6 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje: “Gjithë ushtarakët që përfitojnë banesë sipas këtij vendimi, janë të detyruar të vënë në dispozicion të dikastereve nga varen banesat ekzistuese të privatizuara. Është kompetencë e Ministrisë së Mbrojtjes, Ministrisë së Brendshme dhe SHIK-ut që këto banesa të liruara t’i përdorin për punonjësit e tjerë të pastrehë dhe të paraqesin në Entin Kombëtar të Banesave listat përkatëse për lidhjen e kontratave të shitjes”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi